



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Prishtinës
Pristina Obstina-Municipality of Pristina



SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61 paragrafi 61.3. lidhur me nenin 63 paragrafin 63.1.2. të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik "Professional Alarm" L.L.C të datës 24.05.2023 kundër njoftimit mbi vendimin të datës 19.05.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Furnizimi dhe montimi laurave, pengesave të hyrjes së automjeteve në objektet e Komunës" me nr. të prokurimit 616-23-1625-1-2-1, Komuna e Prishtinës (autoriteti kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **MIRATOHET** kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik "Professional Alarm" L.L.C e datës 24.05.2023 kundër njoftimit mbi vendimin të datës 19.05.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Furnizimi dhe montimi laurave, pengesave të hyrjes së automjeteve në objektet e Komunës" me nr. të prokurimit 616-23-1625-1-2-1 ashtu që **ANULOHET** njoftimi mbi vendimin i datës 19.05.2023 i autoritetit kontraktues lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.
- II. **DETYROHET** autoriteti kontraktues - Komuna e Prishtinës që të dërgoj në rivlerësim aktivitetin e prokurimit nga pika I e këtij vendimi.
- III. **NJOFTOHET** operatori ekonomik "Professional Alarm" L.L.C si dhe të gjitha palët tjera të interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Operatori ekonomik "Professional Alarm" L.L.C (tutje "parashtruesi") me datë 24.05.2023 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit mbi vendimin të datës 19.05.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Furnizimi dhe montimi laurave, pengesave të hyrjes së automjeteve në objektet e Komunës" me nr. të prokurimit 616-23-1625-1-2-1.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritor (*in meritum*) të kërkesës. Pretendimet e parashtruesit janë cituar si në vijim.

- 1. Pretendimi i parë:** *“OE Armakos ka dorëzuar Sigurin e Tenderi nga K.S Sigkos Sh.a me numer te polices 060010150089211 te leshuar me date 27.03.2023. Në bazë të kërkesave të parashtruara në Njoftimin për Kontratë dhe Dosjen e Tenderit afati i vlefshmërisë së sigurimit të tenderit është përcaktuar 90 ditë nga data e hapjes së ofertave, e që i bie se në rastin konkret validitetit i sigurimit të tenderit të OE Fitues është dashur të jetë nga data 27.04.2023, datë në të cilën është bërë hapja e ofertave, mirëpo në fakt OE Fitues e ka dorëzuar sigurimin e tenderit me vlefshmëri duke filluar nga data 27.03.2023”.*
- 2. Pretendimi i dytë:** *“Gjithashtu OE I shperblyer me kontrate ka mangesi edhe ne aspektin teknik te ofertes pasi qe nuk ka dorëzuar specifikimet e detajuar katalogun edhe pse gjate procesit te vlersimit AK ka kerkuar te dorëzohen specifikimet e detajuar OE e ka dorëzuar nje user guide ne te cilin mungon shenimi qe barriera eshte e ploteson standardin EN-12453, mungon shenimi qe barriera ka te integruar i pranuesin (receiver) per telekomandim me dhe një telekomande te cilat duhet te punojen ne frekuencë 868.95MHz, moduli pranues duhet te kete mundesin te pranoj deri ne 40 telekomanda , mungon specifikimi per pozicioni Sensorë sigurie për të parandaluar mbylljen e pengesës gjatë kalimit të një automjeti certifikata qe rrjdhimisht nuk dihet se cilin model e ka ofertuar per kete pozicion si dhe nuk jane prezentuar certifikatat valide ISO te prodhuesit te cilat kane qene kerkese ne pjesen e specifikimeve teknike EN ISO 9001:2015 dhe DIN EN ISO 50001:2018”.*

Për shkak të pretendimeve si më sipër, parashtruesi konsideron se autoriteti kontraktues – Komuna e Prishtinës në këtë aktivitet të prokurimit ka vepruar në kundërshtim me nenin 7, 57 dhe 59 par. 4 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik (tutje “LPP”).

Me qëllim të shqyrtimit të pretendimeve të parashtruesit, janë administruar provat materiale si në vijim:

- B05 Njoftimi për kontratë dhe dosja e tenderit të datës 03.03.2023.
- Formulari standard për korigjimin e gabimeve në njoftimet e publikuara, dt. 21.03.2023.
- Formulari standard për korigjimin e gabimeve në njoftimet e publikuara, dt. 30.03.2023.
- Formulari standard për korigjimin e gabimeve në njoftimet e publikuara, dt. 05.04.2023.
- Formulari standard për korigjimin e gabimeve në njoftimet e publikuara, dt. 13.04.2023.
- Oferta e tenderuesit të rekomanduar Armakos” Sh.P.K..
- Procesverbali i hapjes së tenderëve i datës 27.04.2023.
- Dokumentet shtojca – kërkesat për sqarim dhe sqarimet e ofruara.
- Raporti i komisionit për vlerësim i datës 19.05.2023.
- Njoftimi mbi vendimin e autoritetit kontratës i datës 19.05.2023.

Autoriteti Kontraktues – Komuna e Prishtinës përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit me datë 29.05.2023 ka trajtuar kërkesën e parashtruesit për rishqyrtim. Pas analizimit të pretendimeve të parashtruesit është gjetur se pretendimet e parashtruesit janë të bazuara në kuptim të nenit 63 paragrafit 63.1. nën paragrafi 63.1.2. të RRPP.

Lidhur me pretendimin e parë – fillimisht duhet cekur se sipas dosjes së tenderit (tutje “DT”) nr. i nenit 13.2 është përcaktuar se shuma e sigurimit të tenderit është 1,000.00 Euro për 90 ditë. Në anën tjetër përmes formularit B54 Formularit standard për korigjimin e gabimeve në njoftimet e publikuara të dt. 13.04.2023 është bërë njoftimi se hapja e ofertave do të bëhet me datë 27.04.2023 në ora 13:30. Ky fakt mund të konfirmohet edhe përmes procesverbalit të hapjes së tenderëve të datës 27.04.2023. Pra nuk është aspak kontestuese që kriteri i DT ka qenë siguri i tenderit me vlefshmëri prej 90 ditëve konkretisht duke filluar nga data e hapjes së tenderëve me 27.04.2023 deri me datë 25.07.2023. Tutje si provë është administruar edhe oferta e tenderuesit të rekomanduar “Armakos” Sh.P.K. ku është gjetur se i njëjti ka dorëzuar edhe sigurinë e tenderit sipas nr. të policës 060010150089211 në shumën 1,000.00 Euro me vlefshmëri nga data 27.03.2023 deri me 25.06.2023. Polica e sigurimit është lëshuar nga K.S. “SIGKOS” Sh.a. me datë 27.03.2023. Kjo nënkupton që vlefshmëria e sigurimit të tenderit në rastin konkret përfundon para datës 25.07.2023 dhe rrjedhimisht nuk është në përputhje me kriterin e DT. Në këtë mënyrë është gjetur se pretendimi i parë i parashtruesit është i bazuar pasi që komisioni vlerësues ka bërë shkelje të nenit 59 të LPP lidhur me nenin 28 të RRPP.

Lidhur me pretendimin e dytë – nuk është arritur të vërtetohet se mungojnë dëshmitë që pretendon parashtruesi lidhur me kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale të DT. Prandaj pretendimi i dytë i parashtruesit është i pabazuar.

Nga sa u tha më sipër është gjetur se parashtruesi ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimin e tij të parë. Njëkohësisht nga provat materiale të administruara lidhur me këtë kërkesë për rishqyrtim është konfirmuar se pretendimi i parë i parashtruesit është tërësisht i bazuar. Kjo pasi që është gjetur se komisioni vlerësues ka vepruar në kundërshtim me nenin 59 të LPP lidhur me nenin 28 të RRPP. Për këto arsye është miratuar si e bazuar kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 paragrafin 63.1.2. të RRPP. Për pikën III dhe pikën IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 paragrafin 63.2. të RRPP.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 29.05.2023

Visar SHEHU

Ud. Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit
Komuna e Prishtinës

Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.

Faqe 3 nga 3

Adresa: Rr. “UÇK” nr. 2, Prishtinë 10000

Tel.: 038-200-40-111

Email: visar.shehu@rks-gov.net